

AKTUALITET > Ekzekutimi i dy personave në Tiranë, ndaj automjetit u qëllua me breshëri

AKTUALITET KRONIKE

Ekzekutimi i dy personave në Tiranë, ndaj automjetit u qëllua me breshëri

21:19 : 13/11/2021

🔗 Share f 🐦 ✉



Erigers Mihasi 32 vjeç dhe Armando Dumani, 26 vjeç, janë viktimat nga atentati që ndodhi në zonën e Astirit në Tiranë.

Dy viktimat po qarkullonin me një automjet Audi A8, kur ndaj tyre u qëllua me breshëri automatike, nga një tjetër automjet. Mësohet se dy të rinjtë janë qëlluar me breshëri kallashnikovi, edhe pse nga raportimet mësohet se nuk janë dëgjuar të shtënat. Në automjetin e viktimave ka të paktën 15 gjurmë plumbash, 9 prej të cilave janë në një prej dyerve.

Referuar burimeve nga vendi i ngjarjes, ndaj automjetit që qarkullonin viktimat është qëlluar në xhamin e parë të automjetit, por edhe në xhamin anësor në anën e shoferit.

LEXO EDHE Blerje banesash, truall dhe huapërdorje, ja cila është skeda e pasurisë për prokuroren e Fierit gjatë viteve 2005-2018

Policia ka ngritur disa postobloqe në pikat hyrëse dhe dalëse të Tiranës. Gjithsesi raportohet se në Thumanë është gjetur një automjet i djegur, që ndoshta është përdorur nga autorët në këtë krim.

Por ka dyshime se ndoshta automjeti tip Honda, që është gjetur i djegur, mund të jetë djegur për të tërhequr vëmendjen nga ngjarja dhe autorët mund të jenë larguar në një tjetër drejtim.

Policia është treguar shumë e rezervuar lidhur me ngjarjen, ndërsa trupat e viktimave janë larguar nga vendi i ngjarjes rreth 90 minuta pas atentatit.

Për t’u bërë pjesë e grupit mjafton të klikoni: JOIN GROUP

🔗 Share f 🐦 ✉

Të Fundit



Ajeti: Shpresoj të rikthehem në Kombëtare, te Padova synohet Seria B

23:58 : 17/11/2021

0

Arlind Ajeti arriti më në fund të gjej një skuadër. Mbrojtësi 28 vjeçar nënshkroi me Padovan në Serinë B italiane.Ajeti ishte pa ekip prej...




Horoskopi i ditës së enjte, 18 Nëntor 2021

23:54 : 17/11/2021




A e dinit se limoni ndihmon për një gjumë të rehatshëm?

23:44 : 17/11/2021




Pastrimi i parave të mafias në Shqipëri, Ervin Karamuço ngre alarmin:...

23:39 : 17/11/2021




Përse Ri infektohemi? Çfarë ndodh me efektin mbrojtës të vaksinave

23:32 : 17/11/2021




Konsumoi alkool në grumbullim, Bosnja përjashton Pjanic

23:29 : 17/11/2021



Dalin përgjimet/ Zbulohet oferta e Taçit për bosët e Cosa Nostra-s

23:28 : 17/11/2021



Parashikimi i motit për ditën e enjte, 18 Nëntor 2021

23:13 : 17/11/2021

RRETH NESH



Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.

Na kontakto: boldnews.al@gmail.com

NA NDIQ

